



Në bazë të nenit 4, paragrafi 2 lidhur me nënparagrafin 1.1 të nenit 10 të Ligjit mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Ligji nr. 03/L-139, i datës 26.03.2009, pas shqyrtimit, komentimit dhe intervistimit të palëve, Kryetari i Komunës së Vitisë, me datën 20.02.2015, mori këtë:

Pranuar - Primitjencë Më/Dana 23.02.2015 vit/gj.			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednohet
02-	013/215		

VENDIM PRELIMINAR

Miratohet shpronësimi i pronave të paluajtshme për ngastrat me nr. 1008-0, me sipërfaqe prej 468 m², ngastrën me nr. 1009-0, me sipërfaqe prej 1983 m², në pronësi të Islam Ismajlit (Halim), ngastra me nr. 1012-2 me sipërfaqe prej 1121 m², në pronësi të Hekrem Ismajlit (Hamdi) dhe ngastra me nr. 1013-0, me sipërfaqe prej 1608 m², në pronësi të Feriz Ismajli (Halim), të gjitha në zonë kadastrale në Beguncë, të cilat janë pjesë e këtij vendimi për shpronësim, në të cilat parcela do të ndërtohet shkolla fillore për fshatin Beguncë.

Arsyetim

Komuna e Vitisë, si organ shpronësues, me veteiniciativë ka filluar me punët përgatitore për fillimin e ndërtimit të projektit për ndërtimin e shkollës fillore për fshatin Beguncë, që do të thotë se shpronësimi i pasurisë së paluajtshme bëhet drejtpërdrejt për arritjen e qëllimit publik të qartë, pra duke i plotësuar kushtet nga nën paragrafi 1.1 deri 1.4 dhe 2.4.2 të nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Projekti përfshin një hapësirë të caktuar dhe për arritjen me suksese të përfundimit të tij Komuna është dashur të filloj me procedura për shpronësimin e këtyre paluajtshmërive, të cilat janë në pronësi të Islam Ismajlit (Halim), Hekrem Ismajlit (Hamdi) dhe Feriz Ismajlit (Halim) të gjithë nga fshati Beguncë i Komunës së Vitisë.

Lartësia e kompensimit për pronat e shpronësuara do të caktohet me vonë me vendim përfundimtar. Prandaj, pasi janë plotësuar kushtet ligjore për iniciimin e procedurës së shpronësimit u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi preliminar.

Ky vendim hynë në fuqi pas shpalljes së tij në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazet ditore të Kosovës me tirazh të madh.

UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij vendimi mund të paraqesin ankesë për pjesën e ngastrës së vete, pronari apo pretenduesi i pronës e cila do të shpronësohet. Ankesa behet mbi ligjshmërinë e shpronësimit të propozuar dhe i dërgohet për shqyrtim Gjykatës Komunale në Viti.

Vendimi iu dërgohet :

- Palëve të cilëve i shpronësohet prona apo përfaqësuesit të tyre,
- Drejtorisë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, dhe
- Arkivit të Komunës.

